



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT I SHKURTËR

Nga procesverbali i mbledhjes së 13-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 26.04.2023, në shkollën fillore “Zenel Hajdini” në Gadime në ora 10,⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Skender Bikliqi, kryesues
2. Gentianë Hoxhaj, anëtare
3. Shahadije Bikliqi Dragaçina, anëtare
4. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
5. Enver Kryeziu, anëtar
6. Idajet Garip, anëtar
7. Zoran Cirkovic, anëtar
8. Ana Guciç, anëtare
9. Sllavisa Trajkovic

Të tjerë prezent

1. Skender Ademi, drejtor i shkollës, “Zenel Hajdini” në Gadime
2. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
3. Përfaqësues të OSBE-së, UNMIK-ut
4. Të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**,

Kryesuesi i Komitetit Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se këtë takim e kemi caktuar në teren me qëllim që të njoftohemi për së afërmi me gjendjen e komuniteteve në shkollën e Gadimes. Pastaj tha ftesën me material e keni marrë me kohë dhe e lexoi në vazhdim:

REND DITE

1. Vizitë në teren me drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme ku komunitetet gravitojnë (në fshatin Gadime) si po zhvillohet procesi mësimor tek këto klasa me komunitete

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimisht aprovoi këtë:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Vizitë ne teren me drejtorët e shkollave fillore dhe te mesme ku komunitetet gravitojnë (në fshatin Gadime) si po zhvillohet procesi mësimor tek këto klasa me komunitete

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, ia kaloi fjalën Skender Ademit, drejtorit të shkollës, “Zenel Hajdini” në Gadime, i cili i njoftoi ne pika të shkurta për mësimin qe po mbahet ne këtë shkolla ku tha se ne këtë shkolla ka nxënës të komunitetit jo shumicë afër 15% dhe ka raporte shumë te mira ne mes të nxënësve po ashtu edhe me stafin kalojmë shumë mirë dhe asnjë herë nuk kemi pas asnjë problem.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Gentianë Hoxhaj, tha se sa është numri i nxënësve qe e ka braktisur shkollën a keni ndonjë statistikë?

Shahadije Bikliqi, pyeti sa është numri i përgjithshëm i nxënësve në këtë shkollë?

Zoran Cirkovic, tha se a ka të punësuar ne këtë shkollë nga komuniteti jo shumicë?

Skender Ademi, pyeti se numri i përgjithshëm i nxënësve është mbi 600 nxënës, ndërsa shkollën e kanë braktisur 13 nxënës. Kemi të punësuar nga komuniteti jo shumicë një mirëmbajtës?

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se braktisja e shkollës nga 13 nxënës është shqetësuese dhe ju si drejtori çka keni ndërmarr qe këta nxënës mos ta braktisin shkollën. Dhe cila është arsyeja qe po e braktisin shkollën këta nxënës. A e keni ngrit këtë shqetësim te DKA-ja, apo te zyra e kryetarit.

Skender Ademi, tha se dy nxënës e kanë braktisur për shkak të disa problemeve familjare ndërsa disa te tjerë për shkak të kushteve jo te mira financiare. Edhe pse këshilli i nxënësve se bashku me këshillin e shkollës kane mbledh mjete financiare dhe ju kanë dërguar mjete financiare mbi 800 euro këtyre dy familjeve.

Me qe diskutime tjera nuk pati, kryesuesi tha se po i vizitojmë pak disa klasa nëse nuk e pengojmë procesin mësimor.

Pastaj u vizituan disa klasa për te pari se si po zhvillohen procesi mësimor,

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15⁴⁵.

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit
Skender Bikliqi